



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.08.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.07.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 425, të datës 14.07.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2014, në shumë të përgjithshme prej 2,949,723.17€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër njësitë buxhetore ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Në Administratë buxheti i shpenzuar është 1,085,479.45€,
 - 2.2 Në Arsime buxheti i shpenzuar është 1,331,829.80€,
 - 2.3 Në Shëndetësi buxheti i shpenzuar është 521,306.55€ dhe
 - 2.4 Në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim buxheti i shpenzuar është 11,107.37€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.

**Kryesues i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

20.08.2014

Kuvendi i Komunës , në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur me datë 19.08.2014 , pas shqyrtimit të propozimit me nr. 551 të datës 13.08.2014, paraqitur nga Drejtori për Financa , Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuara në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (b,c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale , Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) , neni 27, shkronja (c,ç) të Statutit të Komunës nr. 98 , i datës 17.08.2012, mori :

V E N D I M

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 551 të datës 17.07.2014 për ridestinimin e mjeteve të lira financiare respektivisht mbetjet nga projektet e përfunduara të transferohen dhe të ridestinohen në ato projekte ku kërkohet financimi i mjeteve ma tepër se sa që janë të planifikuara.
2. **Lejohet Ridestinim i mjeteve nga fondi burimor 10 dhe 21;**
 - 2.1 **Kulturë rini dhe sport (850) nënë programi (85002) në shumë prej 19,291.63 € , si në vijim:**
 - Nënë programi 85002 10 89218 Fushat e Sportit futboll të madh dhe të vogël -19,291.63€
 - Nënë programi 85002 10 89217 Ndërtimi i palestrave sportive 19,291.63€
 - 2.2 **Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (730) nënë programi (73011) në shumë prej 30,000.00€ si në vijim:**
 - Nënë programi 73011 21 89211 Ndërtimi i ambulantes në Fushë- Kosovë - 30,000.00€
 - Nënë programi 73011 21 89209 Zgjerimi i objektit të QKMF kati i II 30,000.00€
 - 2.3 **Arsim dhe shkencë (920) nënë programi (92010) në shumë prej 13,649.22€, si në vijim;**
 - Nënë programi 92010 21 89222 Ndërtimi i shkollës së re në fshatin Pomozotin -13,649.22 €
 - Nënë programi 92010 21 89219 Mirëmbajtja e objekteve shkollore 13,649.22€
3. **Lejohet Ridestinimi i mjeteve nga fondi 22**
 - 3.1 **Shëndetësi dhe mirëqenie sociale (730) nënë programi (73011) në shumë prej 12 ,328.73€ si në vijim:**
 - Nënë programi 73011 22 87179 Rregullimi i oborreve të amulantave -9,574.21€
 - Nënë programi 73011 22 89209 Zgjerimi i objektit të QKMF kati i II 9,574.21€
4. **Lejohet transferi i mjeteve nga fondi burimor 22**
 - 4.1 **Nga programi buxhetor –planifikim urban dhe mjedis (660) nënë programi (66015) në shumë prej 5,953.45€ në programin shërbime publike (180) nënë programi (18162) , si në vijim:**
 - 66015 22 87162 Asfaltimi në Fushë- Kosovë -575.65€
 - 66015 22 87166 Asfaltimi në Sllatinë të Madhe -1,083.00€
 - 66015 22 87167 Asfaltimi në Vragoli -3,000.00€
 - 66015 22 87171 Asfaltimi në Lismir -831.80€
 - 66015 22 87175 Asfaltimi në Henc -463.00€
 - 18162 22 89184 Rregullimi i parkut të pishat Sllatinë e Vogël 5,953.45€

5. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Drejtorisë për Financa , Buxhet dhe Pronë.
6. Ky vendim hyn në fuqi , ditën e aprovimit , nga Kuvendi i Komunës.
- Akti i Dorzohet : Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:

Fadil Krasniqi

